

STATUT I SHOQERISE
“UBU CONSULTING” Sh.P.K

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise, organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me **10 Maj 2024**, personi i meposhtem:

Z. Cristiano Fini, shtetas italian, lindur me 12.02.1973, ne Rome (RM), Itali e banues ne Itali, mbajtes i kartes se identitetit me nr. YA6958993, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratuan kete Statut si vijon:

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji 9901/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” eshte ky Statut i Shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 10.05.2024, une, themeluesi i mesiperm, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar “**UBU CONSULTING**” SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Brenda kufijve të dispozitave të legjislacionit aktual dhe me respektimin e autorizimeve dhe/ose licencave që mund të kërkohen nga ligji, qëllimi i shoqërisë është: *Konsulence komunikimi ne Web dhe Design.*

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete **e pakufizuar**.



Neni 4

Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga "Pjeter Bogdani", G. 13, K. I (prane Dia consulting), Tirane, Shqiperi.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **10,000 LEKE (dhjetemije leke)** dhe zoterohet teresisht nga ortaku themelues:

- **Z. Cristiano Fini** : Zoterues i **1 (nje) kuote** me vlere te pergjithshme 10,000 Leke (dhjetemije leke) qe perben **100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.**

Kontributi i ortakut eshte ne para.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, trashegimise, dhurimit, ose çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Çdo disponim ne favor te nje pale te trete nepermjet veprimeve juridike ndermjet te gjalleve duhet te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjeseve te kapitalit me kundershperblim, ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes.



Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, i cili pervec kompetencave te tjera te parashikuara ne Ligjin per Shoqerite tregtare ose ne kete Statut, vendos per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te ketij neni;
- f) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- m) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- n) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9 Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se pergjithshme mund te behet nepermjet nje njoftimi me shkrese ose permes postes elektronike ne adresat e ortakeve, te cilat do t'i njoftohen Shoqerise me shkrim. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes



dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, te pakten 14 (katermbedhete) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e Pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese Asambleja e Pergjithshme merr vendim per: vleresimin e veprimtarise se tij; shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij; ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria; dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.



Neni 13

Administrimi

Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripërteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje mandat 5 (pese) vjeçar emerimi: **Z. Cristiano Fini**, shtetas italian, lindur me 12.02.1973 ne Rome (RM) e banues ne Itali, mbajtes i leternjoftimit me nr. YA6958993, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesoje Shoqerine;
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizojte persona te tjere per te vepruar ne emer dhe per llogari te tij, duke specifikuar/percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje.


Kreu IV

Viti financiar. Llogaritje vjetore, fitimet dhe rezervat ligjore

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh e cila fillon 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbaron me 31 Dhjetor.



Neni 15
Ekspertet

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeruje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

Neni 16
Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 17
Dividentet

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe rezultatit financiar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

Kreu V
Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

Neni 18
Prishja dhe likuidimi


Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne çdo kohe: (i) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; ose (ii) me vendim te Asamblese se Ortakeve; ose (iii) me hapjen e procedurave te falimentimit; ose (iv) ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; ose (v) me vendim te gjykates.

Ne kete rast, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesisë paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.



Neni 19
Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21
Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e te ciles ka seline Shoqeria.

Ky Statut neshkruhet rregullisht ne gjuhen Shqipe dhe Italiane.

ORTAKU THEMELUES
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"UBU CONSULTING" Sh.P.K.

Z. Cristiano Fini

CRISTIANO FINI
